

Vendim nr. 10 datë 15.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 15.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (B) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

BELUL KOKOLLARI

OBJEKTI:

Kundërshtimi i vendimeve nr. 141, datë 26.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 250, datë 27.07.2022 të Gjykatës së Apeli Vlorë; nr. 00-2024-995, datë 30.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pavlefshmëria e provave të familjes Spahiu.

Pavlefshmëria e akteve të falsifikuara nga familja Spahiu, në shkelje të ligjit.

Interpretimi i nenit 144 të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE:

Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat në vitin 2021, mbi bazën e kallëzimit të dërguar nga Komisariati i Policisë Berat, ka regjistruar ndaj kërkuesit procedimin penal për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 336, datë 09.12.2021, ka caktuar për kërkuesin masën e sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Pas caktimit të masës, prokuroria ka kryer një sërë veprimesh hetimore, si dhe ka vendosur kryerjen e ekspertimit psikologjik të kërkuesit, për shkak të deklarimeve dhe sjelljes së tij.

3. Me vendimin e datës 09.05.2022 prokuroria ka vendosur zgjatjen afatin të hetimeve paraprake, për periudhën nga data 09.05.2022 deri në datën 09.08.2022, me qëllim kryerjen e aktit të ekspertimit. Vendimi i është komunikuar kërkuesit dhe mbrojtësit të tij. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duke kundërshtuar vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve, pasi, sipas tij, akti i ekspertimit psikologjik nuk ishte i nevojshëm.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, pasi i ka kërkuar parashtrime prokurorisë, e cila ka sqaruar se në rrethanat kur akti i ekspertimit nuk ishte kryer brenda 3 muajve, ishte vendosur shtyrja e afatit të hetimeve, me vendimin nr. 141, datë 26.05.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 250, datë 27.07.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-995, datë 30.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

6. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet e gjykatave për vendosjen e masës së sigurimit të arrestit në burg, si dhe vendimet e dhëna nga gjykatat për kundërshtimin e vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 193, datë 23.09.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit kushtetues individual.

7. Kërkuesi në datën 03.10.2024 (data e shërbimit postar) i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesë sipas objektit, e cila, pas plotësimit të dokumenteve të kërkuara, bazuar

në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar përfundimisht në datën 08.11.2024. Kërkuesi në datën 06.12.2024 ka paraqitur plotësim kërke.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1. *Falsifikimit të provave*, pasi procesi penal ndaj tij ka filluar i bazuar në shpifje, për shkak të shpikjes së krijuar nga ai për prodhimin e energjisë elektrike. Provat mjekoligjore janë të falsifikuara, pasi motra e zëvendësdrojtorit të shkollës së nipit punon në institucion shëndetësor, ku jepen librezat shëndetësore për moshat nga 0 deri në 18 vjeç. Fjalët e thëna nga nipi për veprimet e kryera nga kërkuesi janë të diktuar nga mësuesja dhe psikologja e shkollës. Gjykatat kanë falsifikuar provat dhe kanë kërcënuar dëshmitarët.

8.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetim të përgjithshëm dhe nuk është shprehur për arsyet se përse shkaqet e rekursit nuk janë të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Gjykata e Lartë ka shkruar në mënyrë të gabuar faktet, pasi kallëzimi penal nuk është paraqitur nga shtetasja A.I., por nga shtetasja Sh.S., së cilës ia kishte përgatitur oficerja e Policisë Gjyqësore. Kolegji Penal ka shkruar në vendim se kërkuesi disponon armë, por nuk e akuzon për armëmbajtje, por marrëdhënie seksuale. Gjykata e Lartë nuk ka treguar se ekspertimi mjekoligjor është bërë përpara se të bëhej kallëzimi penal dhe se në telefonin e kërkuesit nuk kishte materiale të pahijshme. Kolegji Penal në vendim padrejtësisht arsyeton se akti i ekspertimit është me rëndësi për fatin e personit nën hetim. Gjykata e Lartë edhe pse i ka shkruar pretendimet në vendim, nuk është shprehur për to. Gjykata e Lartë është shprehur se në shkaqet e rekursit nuk ka shkelje të ligjit, por në fakt ligji është shkelur, pasi pyetja e të miturit është bërë në kundërshtim me nenin 58/b, shkronja “a”, të KPP-së; kërkuesi nuk është arrestuar në Berat, por në doganën e Morinës; janë ndërruar pyetjet në ekzaminimin mjekoligjor nr. 159, datë 10.11.2021; aktekspertimi është regjistruar si akt mjekoligjor fals; ekzaminimi i personit nuk është bërë me endoskopi; është modifikuar fotoja e mesazhit të dërguar nga telefoni i motrës së kërkuesit; nuk është shkruar ora dhe data në procesverbal; janë mbledhur prova pa njoftuar kërkuesin dhe mbrojtësin;

kallëzuesja ka gënjyer kur është shprehur se duhet të shkojë çdo 3 muaj në Kosovë dhe se kërkuesi (i vëllai) shkonte shpesh në shtëpinë e saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në këtë këndvështrim Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejkëmbjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në vështrim të standardeve kushtetuese të elaboruara më sipër, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat vendimin e prokurorisë për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 141, datë 26.05.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

13. Nisur nga çështja konkrete, Kolegji thekson se objekt shqyrtimi në Gjykatë bëhen ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Përndryshe, i njëjti individ do të mund t'i drejtohej Gjykatës disa herë brenda të njëjtit proces gjyqësor, veçmas për çdo pretendim, për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në çdo fazë, si dhe në çdo shkallë të tij dhe më pas, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar, edhe për pretendime të tjera që lidhen me të njëjtin proces gjyqësor. Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre, për të gjitha pretendimet në tërësinë e tyre (*shih vendimet nr. 38, datë 25.04.2017; nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë lënë në fuqi vendimin e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake nuk qëndrojnë të pavarura nga procesi i themelit dhe, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë, në zbatim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Pretendimet e kërkuarit mund të paraqiten në Gjykatë vetëm pas shqyrtimit të çështjes së themelit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këtë kuptim, kërkuari i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kushtetuese të tij gjatë gjykimit të çështjes në themel, si dhe për shqyrtimin e kërtimeve të tij, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Për më tepër, Kolegji evidenton se pretendimet e kërkuarit për të njëjtat vendime gjyqësore janë shqyrtuar edhe më parë nga Kolegji, i cili, me vendimin nr. 193, datë 23.09.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.